

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Llogaridhënia e koordinatorit për të drejtën e informimit

Koordinatori për të drejtën për informim është personi përgjegjës i Autoritetit Publik, i cili ka për detyrë bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës për informim.

Në bazë të pikës 1 të nenit 18, mosrespektimi i dispozitave të Ligjit passjell përgjegjësi administrative për koordinatorët (si dhe për personat përgjegjës - titullarin ose nëpunësin më të lartë civil apo për punonjësit e tjerë (neni 19), për sa kohë nuk ka vepër penale. Sanksionet përfshijnë gjobat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 18 për çdo kundërvajtje të veçantë (gjithsej 17) në rastet e mëposhtme:

Refuzimi të dhënies së informacionit; Moskrijim, mosmbajtje, mospublikim apo mospërditësim i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit ligjor; Mosplotësim i kërkesave për informacione, të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve; Mosregjistrimi i kërkesës për informim, mosaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënave të kontaktit të koordinatorit.; Mosdërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik; Dërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik kur autoriteti që ka marrë kërkesën e ka informacionin e kërkuar, në kundërshtim me kërkesën e pikës 2, të nenit 12 të ligjit; Mosnjoftimi i kërkuarit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar një autoriteti tjetër; Mosrespektimi i kërkesave të pikës 4, të nenit 13, të ligjit, për dhënien e informacionit falas; Refuzim i paarsyetuar i preferencës së kërkuarit për mënyrën e dhënies së informacionit; Mosnjoftim i kërkuarit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 15 të ligjit; Moskryerjen e njoftimeve paraprake, sipas parashikimeve të nenit 16.

Numri i shkeljeve të mundshme dhe ndëshkimet tregojnë se Koordinatori, (si dhe titullari i autoritetit publik apo nëpunësi më i lartë civil), duhet të jenë shumë të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë që të zbatojnë detyrimet e përcaktuara nga Ligji për të drejtën e informimit dhe të garantojnë respektimin e të drejtave të qytetarëve.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim nr. 32 - Bashkia Kavajë

Vendim nr. 34 - Operatori i

Shërbimeve të Kujdesit

Shëndetësor/Njësia Vendore e

Kujdesit Shëndetësor Tiranë

Rekomandimi nr. 26 - Bashkia Klos

Rekomandim nr. 27 - Bashkia Vlorë

Rekomandim nr. 28 - Bashkia Lezhë

Rekomandim nr. 29 - Bashkia Shijak

Rekomandim nr. 30 - Bashkia

Shkodër

Rekomandim nr. 31 - Bashkia Patos

Rekomandim nr. 32 - Bashkia

Durrës

Rekomandim nr. 33 - Bashkia

Skrapar

Rekomandim nr. 34 - Bashkia Dimal

Rekomandim nr. 35 - Bashkia Mat

Rekomandim nr. 36 - Bashkia

Bulqizë

Rekomandim nr. 37 - Bashkia

Tiranë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit korrik, ka dhënë dy vendime urdhërimi në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) dhe 12 Rekomandime për zbatimin e Programit të Transparencës të Njësiave të Vetëqeverisjes Vendore .

Me anë të vendimit nr. 34, datë 29.07.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën e Qendrës Res Publica për refuzimin e dhënies së informacionit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë (Autoritetit Publik), për kërkesën:

- Kopje të analizave të ujit të pijshëm të Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë për periudhën 01.01.2020 e në vazhdim.

Autoriteti Publik në përgjigje të tij refuzonte dhënien e informacionit duke argumentuar se: *"...Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores "Cilësia e Ujit të Pijshëm", ku në pikën 3 dhe 5 është përcaktuar qartë se kujt i jepen këto informacione (sensitive). Pika 3. Për çdo monitorim, struktura rajonale e shëndetit publik harton raportin e monitorimit dhe në rast të konstatimit të parregullsive, jep rekomandime për administratorin e objektit të kontrolluar. Struktura rajonale e shëndetit publik i dërgon nga 1 (një) kopje të raportit të monitorimit administratorit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ISHSH-së rajonale. Pika 5. Rezultatet e këtij monitorimi regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-në rajonale, kur kërkohen prej tyre."*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, KDIMDP vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik dhe argumenti i dhënë për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndron.

KDIMDP vlerëson se, qëllimi i ligjit nr. 10 138, datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik", i

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

ndryshuar, është mbrojtja e shëndetit dhe promovimi i jetesës së shëndetshme të popullatës në Republikën e Shqipërisë, përmes veprimeve të organizuara, ndikimi i të cilave shpërndahet, në mënyrë të barabartë, në të gjithë grupet e popullatës.

Të njëjtin qëllim ka edhe Rregullorja "Cilësia e Ujit të Pijshëm", miratuar me VKM-në nr. 379, datë 25.05.2016 ", mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së ujit, duke siguruar që uji është i shëndetshëm dhe i pastër. Në këtë kuptim, një nga mënyrat e arritjes së këtij qëllimi është dhe informimi, i cili parashikohet në nenin 26 të kësaj rregullorje, përkatësisht në pikën 1, ku përcaktohet se: "1. Informacioni i dhënë përdoruesve duhet të jetë i besueshëm, i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i përditësuar në çdo aspekt të përshkruar në këtë rregullore, përmes çdo mjeti të mundshëm komunikimi nga secili autoritet kompetent i përfshirë dhe nga administratorët."

Komisioneri vlerëson se dispozitat e cituara nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, për refuzimin e dhënies së dokumentacionit, nuk janë të zbatueshme në rastin konkret. Dhënia e informacionit për strukturat përkatëse kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i detyrës funksionale në kuadër të veprimtarisë që ky autoritet ushtron, por, në asnjë rast nuk citon ndalimin e dhënies së informacionit për subjekte të tjera.

Në përfundim të procesit administrativ, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.


Bashkëpunimi i Zyrës së Komisionerit me Ambasadën Britanike

Projekti “Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë së qeverive të Ballkanit Perëndimor përmes zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike” (*Improving the openness and accountability of the governments of the Western Balkans through the development of effective strategic communications*) është një iniciativë, ku si pjesë të saj të rëndësishme, ka rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së Autoriteteve Publike shqiptare.

Projekti zbatohet nga Zyra për Komunikim të Shërbimeve Ndërkombëtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike dhe Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky projekt synon forcimin e veprimtarisë së Autoriteteve Publike për t’ju përgjigjur në mënyrë proaktive dhe efektive kërkesave për informacion.

Ky projekt i cili ka filluar të zbatohet në muajin korrik të vitit 2021 do të vazhdojë për një periudhë 3 vjecare dhe do të kontribuojë në përmirësimin e komunikimit të autoriteteve publike me qytetarët në lidhje me të drejtën e tyre për informim.



TRANSPARENCA PROAKTIVE, EKSPERIENCË BRITANIKE NË RRRITJEN E PËRGJEGJSHMËRISË SË AUTORITETEVE PUBLIKE

Në kuadër të projektit dhe bashkëpunimit me Ambasadën Britanike, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar një seri takimesh me përfaqësues të Zyrës për Komunikim të Shërbimeve Ndërkombëtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, për të diskutuar lidhur me problematikat që hasen në zbatimin e të drejtës për informim, praktikës së përditshme dhe rolin e koordinatorit në Shqipëri.

Si rezultat i këtyre mbledhjeve, Zyra e Komisionerit së bashku me mbështetjen e Ambasadës Britanike dhe Zyrës për Komunikim të Shërbimeve Ndërkombëtare zhvilluan një takim me tryeza të rrumbullakëta, me pjesëmarrjen e koordinatorëve nga institucionet kryesore në vend, për të adresuar problematikat dhe shkëmbyer eksperiencë ndërmjet tyre. Takimi kishte në fokus njohjen me situatën aktuale dhe sigurimin e një mbështetje strategjike të komunikimit, në mënyrë që të drejtat dhe detyrimet mbi aksesin në informacion t'u garantohet qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile apo medias. Ndër çështje kryesore që u diskutuan ishte përmirësimi i praktikave institucionale të komunikimit strategjik të Autoriteteve Publike, forcimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit brenda strukturës organizative apo trajnimi i vazhdueshëm i këtyre të fundit.

Në aktivitetin e parë, të mbajtur në formën e tryezës së rrumbullakët, pjesëmarrës ishin koordinatorët për të drejtën e informimit nga 20 institucione qendrore/të varësisë dhe atyre të pavarura.

